

Prof. Dr. Gentiana Sharku (Cane)

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Financës, të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune njëzet e pesë vjeçare si pedagoge dhe studiuese. Në vitin 1997 është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, ndërsa në vitin 2006 është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në sistemin pa shkeputje nga puna. Në vitin 2008 ka mbrojtur doktoraturën me temë “Sigurimi i jetës si mjet ekonomik mbrojtës për individin”; në vitin 2022 ka marrë titullin akademik “Profesor”.

Gjithashtu ka qenë lektore me kohë të pjesshme në disa universitete brenda dhe jashtë vendit. Ka marrë pjesë në kualifikime të ndryshme jashtë vendit dhe në projekte ndërkombëtare të financuar nga programi Tempus, Intereg, Erasmus+ etj.

Ka qenë anëtare e Këshillit të Fakultetit dhe Komisionit për dhënien e gradave shkencore në Fakultetin e Ekonomisë. Ka qenë eksperte e angazhuar pranë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për kualifikimin dhe trainimin e brokerave dhe agjentëve në tregun e sigurimeve, anëtare e komitetit të Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe aktualisht është eksperte e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Fusha e kërkimit të saj është përqëndruar në tregjet, instrumentet dhe institucionet financiare, drejtimin financiar dhe industrinë e sigurimeve.

Ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e të cilave janë zhvilluar në vendet e BE dhe ka botuar artikuj në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit të indeksuara dhe me faktor impakti,